

VENDIM
Nr. 808, datë 28.12.2023

**PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE TË
GARDËS SË REPUBLIKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i përgjithshëm i punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë është 1 505 (një mijë e pesëqind e pesë) veta.

2. Vendimi nr. 445, datë 22.5.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës e të limitit organik dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese për Çdo gradë në Gardën e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Garda e Republikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet më 1 janar 2024.

KRYEMINISTËR
Edi Rama